

Trajtoni që nga fillimi i rritjes së kërcellit (faza 30 e shkallës VVSN) deri në fund të lulëzimit (faza 69 e shkallës VVSN). 2. Sasi e përdorimit 1L/ha (10ml/100m²) në kulturën e elbit, kundër shkaktarëve të njollosjes rrjetore të gjetheve (*Pyrenophora teres*), njollosjes së gjetheve të elbit (*Rhynchosporium secalis*), ndryshkut të gjetheve (*Puccinia hordei*), hirit të gjetheve (*Erysiphe graminis*) dhe njollosjes me vija (*Ramularia collo-cygni*). Për të kontrolluar shkaktarin e fuzariozave (*Fusarium spp.*) aplikohet në sasinë 1,25L/ha (12,5ml/100m²). Trajtoni nga fillimi i rritjes së kërcellit (faza 30 e shkallës VVSN) deri në fillimin e lulëzimit (faza 61 e shkallës VVSN). 3. Në thekër, kundër shkaktarëve të ndryshkut të gjetheve (*Puccinia recondita*), hirit të gjetheve (*Erysiphe graminis*) dhe njollosjes së gjetheve (*Rhynchosporium secalis*) në sasinë e përdorimit 1L/ha (10ml/100m²). Për të kontrolluar shkaktarin e fuzariozave (*Fusarium spp.*) aplikohet në sasinë 1,25 L/ha (12,5 ml/100m²). Trajtoni që nga fillimi i rritjes së kërcellit (faza 30 e shkallës VVSN) deri në fund të lulëzimit (faza 69 e shkallës VVSN). 4. Në sasinë e aplikimit prej 1 L/ha (10 ml/100m²) në tërshërë, kundër shkaktarëve të ndryshkut të kurorëzuar të tërshërës (*Puccinia coronata*) dhe hirit të gjetheve (*Erysiphe graminis*). Për të kontrolluar shkaktarin e fuzariozave (*Fusarium spp.*) aplikohet në sasinë 1,25 L/ha (12,5 ml/100m²). Trajtoni nga fillimi i rritjes së kërcellit (faza 30 e shkallës VVSN) deri në fillimin e lulëzimit (faza 61 e shkallës VVSN). 5. Në sasinë e aplikimit 1 L/ha (10 ml/100m²) në tretikale, për shkaktarin e njollosjes thjerrëzore të drithërave (*Pseudocercospora herpotrichoides*). Për të kontrolluar shkaktarin e fuzariozave (*Fusarium spp.*) aplikoni në sasinë prej 1,25 L/ha (12,5 ml/100m²). Trajtoni që nga fillimi i rritjes së kërcellit (faza 30 e shkallës VVSN) deri në fund të lulëzimit (faza 69 e shkallës VVSN).

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

100ml, 500ml, 1L, 5L.

6. VËREJTJE:

Fitotoksiciteti: preparati nuk është fitotoksik nëse aplikohet në sasinë e rekomanduar dhe në përputhje me udhëzimet e prodhuesit. Për organizmat ujorë (toksiciteti): shumë toksik për jetën ujore me pasoja afatgjata. Parandaloni hyrjen e preparatit në ujë (rrjedha ujore, liqene, burime furnizimi me ujë) dhe në rrjetin e ujërave të zeza. Për ujin (ndotja): gjatë trajtimit, respektoni zonat mbrojtëse të ujit dhe parandaloni ndotjen e ujit (rrjedha ujore, liqene, burimet e ujit dhe puse/bunarë) duke trajtuar të paktën 20m larg tyre.

7. KARENCA:

42 ditë

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS08-i dëmshëm për shëndetin



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-së/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*